



VENDIM

Nr.102 Datë 21.12.2009

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË AKTIVITETIN
E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TE ENERGJISE
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k për licensim në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Dhe Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “GSA” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Vlefshmëria e licenses të filloje nga data e përfundimit të licensës aktuale.

3. Kjo licensë të hyjë në fuqi në datën 26.01.2010 dhe të ketë vlefshmëri deri më datën 25.01.2015.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve

-
4. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,
VENDIM
Nr.102 Datë 21.12.2009

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË AKTIVITETIN
E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TE ENERGJISE
ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____

Shkelqim Bozgo

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta"10
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al